



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:282410

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05811502

KA.nr.245/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Klinika Amerikane “Behar Kusari” SH.P.K, përfaqësuar sipas autorizimit nga Firma e avokatëve Kërveshi & Partners, SH.P.K., kundër të paditurës Inspektorati Shëndetësor Ministria e Shëndetësisë, me seli në Prishtinë përfaqësuar sipas autorizimit nga Fitore Byqmeti, nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.10/K-013/2019 i datës 24/07/2019 dhe Vendimi Nr.Ref/Aj-014 i datës 17.05.2019 të Inspektoratit Shëndetësor si të kundërligjshëm, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 13.05.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, dhe të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 31.05.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Klinika Amerikane “Behar Kusari” SH.P.K, kundër të paditurës Inspektorati Shëndetësor Ministria e Shëndetësisë, me seli në Prishtinë me çka ka kërkuar të anulohet Vendimi Nr.10/K-013/2019 i datës 24/07/2019 dhe Vendimi Nr.Ref/Aj-014 i datës 17.05.2019 i të paditurës, si e pabazuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 26.08.2019, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi “Klinika Amerikane “Behar Kusari”, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Firma e avokatëve Kërveshi & Partners SH.P.K ka parashtruar padi evidentuar me nr. A.2006/19 kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, me kërkesë për anulim të Vendimit i Inspektoratit Shëndetësor i datës 24/07/2019 si i kundërligjshëm, me propozim që të që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadi e paditësit, të anulohet vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/K-013/2019 i datës 24.07.2019 si dhe vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr.Ref./Aj-014 i datës 17.05.2019, si të kundërligjshëm, të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar material dhe në emër të pagesës së gjobës së paguar ti kthej shumën në lartësi prej 20,000.00 euro, në emër të fitimit të humbur shumën prej 123,714.05 euro, në emër të trajtimit mjekësor, riparimit të pajisjeve dhe shpenzimeve të reklamave shumën prej 40,289.46 euro, kamatë vonesë në shumën prej 14,720.28 euro, gjithsej në shumën e tërësishme prej 198,723.79 euro, të gjitha këto brenda afatit ligjor nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 245/22.
3. Gjykata më datë 19.09.2023 mbajti seancë përgatitore, ndërsa seancë të shqyrtimit kryesor publik mbajti me datë: 01.11.2023, 05.02.2024, 18.03.2024, 03.04.2024, 18.04.2024 dhe më datë 13.05.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokate Nazlije Sopa nga firma e avokatisë Kërveshi & Partners SH.P.K sipas autorizimit të datës 08.08.2023 dhe përfaqësuesit të palës së paditur Fitore Byqmeti nga Avokatura Shtetërore, sipas autorizimit të datës 18.09.2023 dhe me pjesëmarrje të ekspertit financiar A.Z..

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se vendimi i goditur me padi ka mungesë të qartësisë juridike dhe arsyetimit të bazuar në dispozita të sakta të legjislacionit në fuqi. Në arsyetimin

e këtij vendimi nuk është e qartë se mbi cilin raport apo raporte dhe cilat dispozita saktësisht të ligjit, udhëzimit administrativ apo ndonjë norme tjetër në fuqi në Kosovë është shkelur saktësisht nga ankuesi. Në paragrafin e tretë të vendimit Kryeinspektori thekson të grumbulluara dispozitat ligjore, e asnjë shkelje nuk e ndërlihdh me dispozitën apo dispozitat që i citon në vendim. Nga UA 06/2013 një sanksion komulativ i tillë parashihet për shkeljen e nenit 5 të UA 06/2013, mirëpo në arsyetimin e vendimit nuk theksohet se ankuesi ka shkelur këtë nen, andaj komulativisht nuk është i ligjshëm një vendim i tillë.

5. Tutje ka theksuar se, shkalla e dytë nuk e ka eliminuar kontradiktorialitetin në mes të arsyetimit dhe dispozitivit. Arsyetimi i vendimit thekson se janë gjetur dëshmi se nga një donatore janë dhënë qeliza më shumë se një pranuese, ndërsa sipas inspektoratit kjo qenka e ndaluar, por një pretendim të tillë nuk e ka mbështetur në ndonjë ligj në fuqi, e nëse e mbështet në UA 06/2013, siç në disa pjesë i citon, atëherë ky UA në nenin 24 të tij përcakton se “ Qelizat gjinore të dhuruara nga një person shfrytëzohen deri në lindjen e më së shumti tre fëmijëve të gjallë”, ndërsa këtij konstatimi shkalla e dytë nuk i referohet fare në arsyetim duke e refuzuar ankesë, si të pa bazuar. Dispozita në fjalë është e qartë duke mos pasur asnjë hapësirë të nevojshme për interpretim ngase qelizat gjinore mund të përdoren deri sa të kenë lindur tre fëmijë nga të njëjtat, ndërsa inspektorati konsideron se ankuesi ka shkelur këtë udhëzim sepse qelizat e dhuruesit janë përdorur-transferuar në 2-3 femra e jo vetëm në një pacient siç është paraparë me UA 06/2013.
6. Ka shtuar se vendimi i nxjerrë nga i padituri duhet të cilësohet si absolutisht i pavlefshëm meqë i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me formën e kërkuar nga Ligji për Procedurën Administrative LPPA përkatësisht neni 48 par.1 neni 92. Vendimi nuk thekson saktësisht se në cilat dosje të viteve 2017 apo dosjet e vitit 2018 është i bazuar dhe ku janë gjetur shkeljet e tilla. Inspektorati Shëndetësor gjatë periudhës 12.03.2018, 05.04.2018 16.05.2018, 28.06.2018 ka kryer inspektime të rregullta në Klinikën Amerikane duke ofruar rekomandimet e veta, por asnjëherë nuk është njoftuar apo informuar se në lidhje me procedurën e IVF-së duhet ndjekur ndonjë standard tjetër, duket të zhvilloj tjetër procedurë apo duhet ndërmerr ndonjë veprim të saktësuar në rekomandime dhe vendimi i kundërshtuar do të mund të ishte i arsyeshëm dhe i peshuar me veprimet/mos veprimet e ankuesit të përsëritura. Vendimi ka për pasojë në mbylljen e një biznesi privat taksapagues i rregullt, punësuar rreth 100 punëtorë, dhe se nga koha e inspektimit biznesi ka rreth 100,000.00 euro humbje dhe se revokimi i licencës i pamundëson klinikës që të operoj. Inspektorati

Shëndetësor ka marr vendim të pa mbështetur juridikisht as në ligj, prova dhe as në gjendjen faktike e as në legjislacionin në fuqi në lidhje me konstatimet e dhëna, dhe duke mos zbatuar procedurën e paraparë me ligj për nxjerrjen e aktit të tillë. Në seancën përgatitore të mbajtur më datë 19.09.2023 i ka propozuar gjykatës nxjerrjen e provës materiale përmes ekspertizës financiare ku detyrë e ekspertit do të jetë llogaritja e dëmit të shkaktuar si pasojë e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë IVF nga data 02.04.2019 e deri me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë IVF, llogaritja e dëmit të shkaktuar të bazohet nga të hyrat e paditësit nga ushtrimi i veprimtarisë IVF nga tre vitet paraprake të nxjerrët një mesatare nga ky fitim dhe pastaj të aplikohet për periudhën sa i është mohuar ushtrimi i këtij aktiviteti e po ashtu duke kalkuluar edhe kamatën prej 8% nga data e paraqitjes së padisë e deri në përpilimin e ekspertizës.

7. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kompetencë ekskluzive për refuzimin, pezullimin apo edhe revokimin e licencave të institucioneve private është bordi për licencim të institucioneve private shëndetësore në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, përcaktuar me nenin 13 par 1, 3 dhe 4 të UA nr.08/2014 për procedurat për licencimin e institucioneve shëndetësore. Institucioni shëndetësor i cili ka marrë pjesë në inspektimin e paditëses ka vendosur në të dy shkallët brenda organit-ISH, e me këtë rast është shkelur parimi i dyshkallshmërisë, vërtetuar nga prova materiale, raporti i inspektimit me nr.Prot:05-2436 i datës 17.05.2019 ku qartë vërehet se personi i cili ka përpiluar këtë raport është Znj.N.K., ndërsa nga prova materiale me titullin vendimi nr.10/K-013/2019 i datës 24.07.2019 vërehet se ky vendim i organit të shkallës së dytë është marrë po nga Znj.N.K. e që i bie se i njëjti person ka marrë pjesë në vendosje në të dy shkallët. Inspektimi është kryer në kundërshtim me ligjin nr.02/L-38 për ISH për faktin se i gjithë inspektimi është kryer nga inspektorët të cilët posedojnë kualifikim më të ulët profesional se sa subjekti i mbikëqyrjes, e kjo bie në kundërshtim me nenin 8 par.2 të ligjit të lartcekur, ndërsa ligji ka paraparë shprehimisht veprimet të cilat duhet të merren nga inspektorati në rastet kur inspektorët anë kualifikim më të ulët profesional se sa objekti i cili i nënshtrohet inspektimit, dhe këto veprime janë të parapara me nenin 1, 2 të ligjit për Inspektoratin Shëndetësor.
8. Sipas parashtresës së datës 18.04.2024 ka bërë precizimin e padisë në të cilën i ka propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/K-013/2019 i datës 24.07.2019 si dhe vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr.Ref./Aj-014 i datës 17.05.2019, si të kundërligjshëm, të

detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar material dhe në emër të pagesës së gjobës së paguar ti kthej shumën në lartësi prej 20,000.00 euro, në emër të fitimit të humbur shumën prej 123,714.05 euro, në emër të trajtimit mjekësor, riparimit të pajisjeve dhe shpenzimeve të reklamave shumën prej 40,289.46 euro, kamatë vonesë në shumën prej 14,720.28 euro, gjithsej në shumën e tërësishme prej 198,723.79 euro, të gjitha këto brenda afatit ligjor nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kundërshtimet e të paditurës

9. Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigje në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe pretendimi i palës paditëse se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron. Inspektorati Shëndetësor kishin konstatuar se ka shkelje të neneve 11 par 1 nën par 1.3 dhe 1.4 neni 15 par 1.3 neni 19 par 1 neni 20 par 3, neni 31 par 1 dhe 2, neni 35 par 1, dhe neni 43 të UA 06/2013, andaj pretendimet se vendimi nuk përmban arsyetim janë të pa bazuara sepse vendimi i Inspektoratit Shëndetësor mban arsyetimin dhe bazën ligjore mbi bazën e te cilës është marrë vendimi mbi refuzimin e ankesës.
10. Tutje gjatë seancës përgatitore të mbajtur më datë 19.09.2023 ka deklaruar se e kundërshtojnë propozimin për marrjen e provës me ekspertizë financiar meqenëse konsiderojnë se vendimin i Inspektoratit Shëndetësor është i drejtë dhe i bazuar në ligj andaj dhe nuk ka bazë ligjore për caktimin e ekspertizës. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit të mbetet në fuqi vendimi i kundërshtuar i Inspektoratit Shëndetësor.

Provat e administruara

11. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar Nr. 10/K-013/2019. 24.07.2019 nga Ministria e Shëndetësisë – Inspektorati Shëndetësorë, Aktvendim për pushimin e hetimeve PP/I Nr.293/2018 e datës 31.01.2023, Procesverbal me nr. 005448 i datës 12.03.2018, Procesverbal i datës 12.03.2018 me nr.006363, Procesverbal me nr. 006102 i datës 28.06.2018 ISH, Raport inspektimi me datë 04.04.2018 me nr. ref.10/AJ-012-18, Raport inspektimi me datë 16.05.2018 me

nr.ref.10/N-025-18, Raport inspektimi me datë 17.05.2019 me nr.2436, Raporti i analizave lidhur me analizat e kryera në laborator i datës 12.06.2017 me kod unik dhurues KU1075, Vërtetim lidhur me njoftimin e pacientit për FAM i datës 21.06.2012, Vlerësim i psikologut klinik për pacienten Gj. S, Vërtetim për pacienten L.M lidhur me njoftimin për Frytnimin e Asistuar Mjekësor (tutje referuar si FAM) i datës 26.02.2018, Vlerësim i psikologut klinik për të njëjtën 18.11.2016, Raport i analizave i datës 01.03.2018 për pacienten S.Q, Vlerësim i psikologut klinik për të njëjtën 18.11.2016, Vërtetim për pacienten S.Q lidhur me njoftimin për FAM, Ankesën ndaj vendimit të shkallës së parë drejtuar kryeinspektorit shëndetësor me nr.10/05-2437/2 e datës 24.05.2019, Dëshmitë për pagesën e gjobës në shumë prej 20 mijë euro, Vendimi i shkallës së parë nr. AJ-014 i datës 17.05.2019, Proces verbalet në bazë të të cilave është marrë vendimi i shkallës së parë me datë 02.04.2019 nr.006304/I, me datë 02.04.2019 nr. 006305/II, me datë 03.04.2019 006306/III, Arsyetim nga Klinika Amerikane me datë 02.04.2019, Një fotografi me te cilën dëshmohet se është ndërpre veprimtaria e përkohshme e paditësit, Informatorë, deklarata mbi dhurimin vullnetarë për FAM, Forma e kompensimit dhe deklarata e dhuruesit e vitit 2019 (data e pa lexueshme), Informatorë për dhuruesit e qelizave vezë për FAM, Pajtim i pacientit me datë 15.03.2017, Informatorë, deklarata mbi dhurimin vullnetarë për FAM për pacienten D.H, H.SH, Forma e kompensimit dhe deklarata e dhuruesit e vitit 2019 (data e pa lexueshme), për pacienten D.H, H.SH, Informatë për dhuruesit e qelizave vezë për FAM, për pacienten D.H, H.SH, Pajtim i pacientit me datë 15.03.2017, për pacienten D.H, H.SH, Dokumenti i lejes së qifteve që i nënshtrohen procedurave IVF, ET, ICSI e datës 15.03.2017, Kërkesë nga paditësi drejtuar ISH me nr.05-1784 i datës 12.04.2019, Ekspertizë Financiare nga eksperti A.Z. e datës 28.12.2023 Plotësim Ekspertizë e ekspertit financiar A.Z. e datës 11.04.2024.

12. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaramet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
13. Nga Vendimi i kundërshtuar Nr. 10/K-013/2019. 24.07.2019 nga Ministria e Shëndetësisë – Inspektorati Shëndetësorë, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit duke e lënë në fuqi vendimin me Nr. 05-2437 i datës 17.05.2019 i Inspektoratit

Shëndetësor, me arsyetim se paditësi Klinika Amerikane ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, ngase qelizat e dhuruesit janë përdorur-transferuar në 2-3 femra e jo vetëm në një pacient siç është e paraparë me UA 06/2013. Në dosjet e pacientëve mungon numri total i embrioneve të përfituara me numrin e embrioneve të transferuar, të ngrirë dhe të asgjësuar të pacientit, pëlqimi i psikologu, pëlqimi i juristit, nënshkrimi i mjekut, mungon regjistri i posaçëm për donator, mungon sistemi i kodimit unik, nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas. Është bërë kompensimi për dhurim të qelizave në vlerë nga 600-800 euro, regjistri i pacientëve është sipas UA 02/2010, dosja e pacientëve të dhuruesve nuk plotësohet me të gjitha të dhënat, mungojnë analizat e obliguara për sëmundje ngjitëse, sëmundjet seksuale te transmetueshme, anamneza e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut me vulë, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të UA 16/2013 për FAM përkatësisht neni 11 par1 nën par. 1.3 dhe 1., neni 15 par.1.3, neni 19 par.1, neni 20 par.3 neni 31 par.1 dhe 2 , neni 35 par.1, dhe nenit 43. për plotësim jo korrekt të dokumenteve shëndetësore parashihet masë ndëshkuese bazuar në UA nr.02/2010. Vendimi i shkallës së dytë është i nënshkruar nga Dr. N.K. UD KryeInspektor Shëndetësor.

14. Nga Procesverbal me nr. 005448 i datës 12.03.2018, inspektorët shëndetësor kanë konstatuar se Institucioni është i licencuar, ofron shërbime gjinekologjike, IVF dhe ORL, janë kontrolluar protokollat e Sava I, Sava II, dhe IVF-së, kanë marrë listën e punëtorëve të klinikës, si dhe disa kontrata dhe licenca të huaja, nuk përmban rekomandime.
15. Nga Procesverbal i datës 12.03.2018 me nr.006363, Inspektorati Shëndetësor ka konstatuar se një numër i madh i pacientëve i nënshtrohen kryerjes së analizës PGS. Para implantimit u kontrolluan dosjet e pacientëve me nr. 68/2700 me numër 07/1458 me numër 25/1313, me numër 69/2801, dosja 07/1458, me numër 128/3401, janë rekomanduar të plotësohen rekomandimet të cilat do të cekën në raport nga Inspektorati Shëndetësor.
16. Nga Procesverbal me nr. 006102 i datës 28.06.2018, Inspektorati shëndetësor ka bërë inspektimin në Klinikën Amerikane në Prishtinë, ku kanë konstatuar se në këtë klinikë me kontratë mbi vepër ishin të angazhuar 22 mjek specialist të gjinekologjisë, janë kontrolluar dosjet e pacientëve me numër rendor 136 dhe pacientja me numër rendor 159

janë rekomanduar të plotësohen rekomandimet të cilat do të ceken në raport nga Inspektorati Shëndetësor.

17. Nga Raport inspektimi me datë 04.04.2018 me nr. ref.10/AJ-012-18, Inspektorati Shëndetësor pran Ministrisë së Shëndetësisë më datë 12.03.2018 bëri inspektimin e planifikuar në Institucionin Privat Shëndetësor “Klinika Amerikane”. Qëllimi i inspektimit ishte verifikimi i respektimit të normave ligjore, etike dhe standardeve të cilësisë si dhe punës së mjekëve të huaj në këtë institucion. Është konstatuar se Klinika Amerikane është e licencuar pran Ministrisë së Shëndetësisë me numër të licencës 02/2017 e datës 24.02.2017 valide deri më datë 23.02.2022. Sipas rekomandimeve i është ndaluar veprimtaria Dr. N.K. deri në Lajmërim pran DLA-së. Është konstatuar se rekomandimet do të jepen me raport. Në rast të mos respektimit të rekomandimeve do të merren masa sipas Ligjit 04/L-125 neni 93 par.2.
18. Nga Raport inspektimi me datë 16.05.2018 me nr. ref.10/N-025-18, Inspektorati Shëndetësor pran Ministrisë së Shëndetësisë më datë 16.05.2018 bëri inspektimin e planifikuar në Institucionin Privat Shëndetësor “Klinika Amerikane”. Inspektimi ishte zhvilluar në dy faza. Faza e parë takimi me menaxherin, Faza e dytë Inspektimi i Institucionit. Nga dosjet e pacientëve është konstatuar se çdo pacienti i është bërë scriningu gjenetik para implantimit. Regjistri i pacientëve që i nënshtroheshin procedurave të FAM-it, ishte sipas UA 02/2010 dhe plotësohej me të gjitha të dhënat. Nga rekomandimet janë rekomanduar që të mos i rekomandohet secilës paciente e cila i nënshtrohet trajtimit mjekësor nga fusha e FAM-it për të bërë scriningun gjenetik para implantimit. Të caktohen indikacionet sipas protokolleve ndërkombëtar për scriningun gjenetik para implantimi. Në rast të mos respektimit të rekomandimeve do të merren masa sipas ligjit 04/L-125 neni 93 par.2.
19. Nga Raport inspektimi me datë 17.05.2019 me nr.2436, Inspektorati Shëndetësor i Republikës së Kosovës më datë 02.04.2019 dhe 03.04.2019 bëri inspektimin e planifikuar me kërkesë të Drejtorisë për Hetime dhe Transferim me Qenie Njerëzore në Institucionin Privat Shëndetësor “Klinika Amerikane”, me qëllim të verifikimit të respektimit të normave ligjore, etike dhe standardeve të cilësisë, punës së mjekëve të huaj në këtë institucion e veçanërisht mbarëvajtjen e punës së Frytnimit të Asistuar IVF. Nga raporti i inspektimit u kontrolluan dosjet e dhuruesve me numër të protokollit 4537, 5737, 8148 ku u konstatua që nuk janë të evidentuara se kujt i janë dhuruar embrionet. Është

bërë tërheqja e 25 qelizave në total, të pacientes me nr. të protokollit 5737 në afat kohor 6 muaj më datë 09.11.2018, 07.01.2019, 25.03.2019, nuk ka asnjë shënim se kujt i janë dhuruar këto qeliza, dokumenti i embrioneve deri në destinacion të fundit mungon. Në bazë të nenit 20 par.3 të UA 06/2013 qelizat e dhuruesit duhet të përdoren vetëm te e njejta femër deri ne lindjen e tre fëmijëve të gjalle, ndërsa në dosjen e pacientit me nr. 960 kanë gjetur që nga një dhuruese janë transferuar qelizat në 2-3 femra. Është bërë kompensimi për dhurim të qelizave në vlerë prej 600-800 euro, që është i evidentuar në dosjen e pacientes me nr. 1075. Është evidentuar që në dosjen e pacientes me nr. 0859/2251 janë të ngrirë 4 embrione, ndërsa në tanke për ruajtjen e embrionit nuk i kishte fare. Mungon sistemi i kodimit për kodin unik të dhuruesit dhe pranuesit me qëllim që të sigurohet vazhdimësia nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas, mungon regjistri i posaçëm për donator (dhurues). Në dosjen e pacientit donatorë me nr. të protokollit 960, 5737, 4537, mungojnë analizat e obliguara për sëmundje ngjitëse, sëmundjes seksuale transmetuese, mungojnë amneza e plotë, e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut me vulë. Inspektorati është njoftuar nga embriologu që në procedurë të IVF për momentin janë vetëm dy pacient. Në kohën e inspektimit në laboratorin e embriologjisë, ishin në inkubator embrionet e 7 pacientëve me iniciale Rr.SH, XH.K, D.J, A.B, S/V, V.K, B.S, F.SH, meqenëse embrionet ishin në fazën e pjekurisë ishte kërkuar me shkrim nga Inspektorati që të lejohet kjo pjesë e klinikës të punoj deri më datë 03.03.2019, që të bëhet kompletimi i fazës zhvillimore për të ruajtur (vitifikim) deri në procedurat e tjera vijuese. Gjatë ditës më datë 02.03.2019 për shkaqe të sigurisë tanket me embrione të ngrira janë transferuar, në Spitalin “Lindja”, për ruajtjen e tyre si dhe të përfundohet procedura e këtyre dy pacientëve të cilat janë në procedurë e sipër. Më datë 03.03.2019 Inspektorati Shëndetësor përsëri nën përcjelljen e njësitit hetues bëri inspektim me qëllim të verifikimit të përfundimit të procedurës të ngrirjes së embrioneve për pacientët e cekur më lartë, ku është konstatuara që procedura kishte përfunduar dhe se këto embrione janë transferuar në Spitalin “Lindja”.

20. Nga te gjeturat si ma larte janë rekomanduar që të ndalohet transferimi i embrioneve të më shumë se një pranues nga një donator, të pajisen me regjistrin e posaçëm për donator, të mbahet evidenca dhe ti raportohet KFAM-it, të sigurohet sistemi i kodimit unik nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas, të ndalohet kompensimi për dhurim të qelizave gjinore që është në kundërshtim me UA 06/2013, Të bëhet përzgjedhje e dhuruesve sipas UA 06/22013, të bëhen analizat e obliguara për këtë procedurë, si dhe të regjistrohen në

dosjen e pacientit, të plotësohet regjistri i pacientëve dhe dosja e pacientëve sipas UA 02/2010. IPSH “Klinikës Amerikane” i është revokuar licenca e punës për shërbimin e IVF-it në afatin kohor prej 1 viti.

21. Nga Vlerësim i psikologut klinik për pacienten Xh.S. ka konstatuar se pacientja Xh.S., para fillimit të procedurës për frytnim mjekësor ka përfunduar këshillimin psikoterapeutik gjatë të cilit psikologu klinik e ka njoftuar me ndikimet e mundshme psikologjike të Frytnimit të Asistuar Mjekësor. E njëjta sipas Vërtetimit lidhur me për FAM të datës 21.06.2012, është e njoftuar me të drejtat dhe pasojat ligjore lidhur me lindjen e foshnjës me FAM dhe pëlqimin e procedurës së FAM, konform me Ligjin nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, Ligjin nr.02/L -76 për shëndetin riprodhues dhe UA 2013/6 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor (tutje referuar si FAM), vërtetimi i lëshuar dhe nënshkruar nga një jurist.
22. Nga Raporti i analizave lidhur me analizat e kryera në laborator i datës 29.11.2016 me kod unik dhurues KU1075, është konstatuar se dhuruesja më datë 29.11.2016 ka filluar procedurën e FAM për pacienten me kod unik 854. është bërë shkrirja e 15 ocisteve, pas shkrirjes janë djeg 2, prej 13 ocisteve, 11 embrione kane mbetur arrest, janë asgjësuar 2x8c/ab kane mbetur te gatshme për transferim.
23. Nga Vërtetim për pacienten L.M lidhur me njoftimin për FAM i datës 26.02.2018, është vërtetuar se e njëjta është njoftuar me të drejtat dhe pasojat ligjore lidhur me lindjen e foshnjës me FAM dhe pëlqimin e procedurës së frytnimit të asistuar mjekësor.
24. Nga Vlerësim i psikologut klinik për pacienten L.M i datës 26.02.2018, është konstatuar se para fillimit të procedurës për frytnim mjekësor ka përfunduar këshillimin psikoterapeutik gjatë të cilit psikologu klinik e ka fituar me ndikimet e mundshme psikologjik të frytnimit të Asistuar mjekësor.
25. Nga Raport i analizave i datës 01.03.2018 për pacienten S.Q, Klinika Amerikane konkretisht Dr. Behar Kusari ka lëshuar raportin më datë 01.03.2018 ku kanë konstatuar se dhuruesja me kod 4064 më datë 26.02.2018 ka filluar procedurën e FAM-it. E njëjta sipas Vlerësimit të psikologut klinik me datë 18.11.2016, para fillimit të procedurës për frytnimin mjekësor, ka përfunduar këshillimin psikoterapeutik gjatë të cilit psikologu klinik e ka njoftuar për ndikimet (efektet) e mundshme psikologjike të FAM-së. Po ashtu

pacientja S.Q është njoftuar me të drejtat dhe pasojat ligjore lidhur me lindjen e foshnjës me FAM dhe pëlqimin e procedurës së frytnimit të asistuar mjekësor.

26. Nga Vendimi i shkallës së parë nr. AJ-014 i datës 17.05.2019, Inspektorati Shëndetësor në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë ka marr vendim me Nr. Ref /Aj-014 të datës 17.05.2019 ku Institucionit Privat Shëndetësor “Klinika Amerikane”, i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore për shërbim të IVF-së. Për shkelje të dispozitave të Ligjit për Shëndetësinë 04/L-125 dhe UA Nr. 06/2013, duke e ndëshkuar në pikën II me gjobë në vlerë prej 20,000.00 euro, (sipas nenit 53 pika 3.1 e UA-se) me arsyetim se në zhvillim e sipër të inspektimit janë kontrolluar dokumentacioni i pacientëve të cilëve u është ofruar shërbim në këtë institucion shëndetësorë dhe se është vërtetuar se qelizat e dhuruesit janë përdorur-transferuar në 2-3 femra e jo vetëm në një pacient siç është e paraparë me UA 06/2013. Në dosjet e pacientëve mungon numri total i embrioneve të përfituara me numrin e embrioneve të transferuar, të ngrirë dhe të asgjësuar të pacientit, pëlqimi i psikologu, pëlqimi i juristit, nënshkrimi i mjekut, mungon regjistri i posaçëm për donator, mungon sistemi i kodimit unik, nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas. Është bërë kompensimi për dhurim të qelizave në vlerë nga 600-800 euro, regjistri i pacientëve është sipas UA 02/2010, dosja e pacientëve të dhuruesve nuk plotësohet me të gjitha të dhënat, mungojnë analizat e obliguara për sëmundje ngjitëse, sëmundjes seksuale transmetuese, anamneza e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut me vulë, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të UA 16/2013 për frytnimin e asistuar mjekësor përkatësisht neni 11 par1 nën par. 1.3 dhe 1., neni 15 par.1.3, neni 19 par.1, neni 20 par.3 neni 31 par.1 dhe 2 , neni 35 par.1, dhe nenit 43. Vendimi i shkallës së parë është i nënshkruar nga Dr. A.Z., Inspektor Shëndetësor.
27. Nga Procesverbalet në bazë të cilave është marrë vendimi i shkallës së parë me datë 02.04.2019 006303, nr.006304/I, nr. 006305/II, me datë 03.04.2019 006306/III, është konstatuar se inspektorati Shëndetësor i Kosovës ka bërë inspektim të planifikuar në Klinikën Amerikane, kanë kërkuar dosjet e pacientëve të cilët kanë kryer procedura t e IVF-së, janë kontrolluar dosjet 4064/12, 1075, 854 dhe u konstatua që mungojnë informatat si numri i embrioneve, pëlqimi pacientit nënshkrimi i dokumentacionit përkatës. Janë marrë kopjet dhe fotot. Sipas procesverbalit me datë 03.04.2019 006306/III, inspektorët kanë konstatuar se është bërë sanimi i embrioneve të cilat kanë qenë në procedurë nga data 02.04.2019, dhe transferimi i këtyre embrioneve në klinikën

Lindja, pjesës së shërbimit IVF iu vu letra ndalimi i përdorimit i punës, janë marrë kopjet e listës së pacientëve embrionet e së cilëve kanë qenë në procedurë.

28. Nga Ankesë ndaj vendimit të shkallës së parë drejtuar kryeinspektorit shëndetësor me nr.10/05-2437/2 e datës 24.05.2019, Klinika Amerikane më datë 24.05.2019 ka parashtruar ankesë drejtuar Kryeinspektorit Shëndetësorë i Ministrisë Shëndetësi përmes Inspektoratit Shëndetësorë, kundër vendimit me numër të protokollit 05-2437 të datës 17.05.2019, të Inspektoratit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë me numër të referencës REF/Aj-014.
29. Nga Dëshmitë për pagesën e gjobës është bërë transferimi i shumës prej 20,000 € (njëzetëmijë euro), euro nga llogaria bankare e V.K. në llogarinë bankare të Ministrisë Shëndetësisë përmes bankës NLB.
30. Nga Arsyetim nga Klinika Amerikane me datë 02.04.2019, pacientëve u është kërkuar kohë deri më datë 03.04.2019 të bëhet kompletimi i fazës zhvillimore për të ruajtur deri në procedurat e tjera vijuese.
31. Sipas dokumentit Informatori, deklarata mbi dhurimin vullnetarë për Frytnimin e Asistuar Mjekësor përshkruhet qëllimi, informimet para fillimit të procedurës për dhurim, procesi i dhurimit, parimet e procedurës për Frytnimin e Asistuar Mjekësor, duke u bazuar në UA nr.06/2017 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor (FAM) e nxjerre nga Ministria e Shëndetësisë, Sipas UA 06/2013 për FAM dhurimi i qelizave gjinore ka karakterin vullnetar, por duke u bazuar në neni 19 par.3 të këtij Udhëzimi të gjitha shpenzimet duke filluar nga transportimi i dhuruesit, analizat e bëra, koha e humbur kompensohen nga Klinika Amerikane.
32. Nga Forma e kompensimit dhe deklarata e dhuruesit e vitit 2019 (data e pa lexueshme), pacienti S.Q ka deklaruar se ka lexuar dhe i janë komentuar të gjitha informatat rreth procedurës së dhurimit, të gjitha të drejtat dhe obligimet si dhurues vullnetar dhe me vetëdije ka pranuar të jetë dhurues vullnetar për qelizat gjinore duke respektuar të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe se i është bërë kompensimi i shpenzimeve të transportit, analizave të bëra dhe kohës së humbur gjatë procedurës së dhurimit kompensimi në shumë prej 400.00 euro pas përfundimit të procedurës së dhurimit dhe se institucioni shëndetësor nuk ka asnjë obligim ndaj dhuruesit.

33. Nga Informatorë për dhuruesit e qelizave vezë për FAM, pacientja S.Q më datë 15.03.2017 ka nënshkruar Informatorin e Qelizave sipas procedurës së Frytnimit të Asistuar Mjekësor (FAM), e cila ka pranuar këtë informator mbi njoftimin e realizimit të procedurës mjekësore të FAM, ka vendosur dhe është pajtuar me vullnetin e vet dhe pa imponim ti nënshtrohet kësaj procedure. E njëjta është informuar se dhurimi i qelizave vezë bazohet ne dhurimin vullnetar dhe të pa paguar duke ruajtur anonimizitetin si të dhuruesit ashtu dhe të pranuesit konform ligjit nr.04/L/125 për Shëndetësi, Ligjin nr. 02/L-76 për Shëndetin riprodhues dhe të UA 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor konkretisht neni 4 pika 3.
34. Nga Informatorë deklarata mbi dhurimin vullnetarë për FAM për pacienten D.H, H.SH, Klinika Amerikane duke u bazuar në UA 06/2017 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor FAM, përshkruhet qëllimi, informimet para fillimit të procedurës për dhurim, procesi i dhurimit, parimet e procedurës për Frytnimin e Asistuar Mjekësor, duke u bazuar në UA nr.06/2017 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor (FAM) e nxjerr nga Ministria e Shëndetësisë, Sipas UA 06/2013 për FAM dhurimi i qelizave gjinore ka karakterin vullnetar, por duke u bazuar në neni 19 par.3 të këtij Udhëzimi të gjitha shpenzimet duke filluar nga transportimi i dhuruesit, analizat e bëra, koha e humbur kompensohet nga Klinika Amerikane.
35. Nga Forma e kompensimit dhe deklarata e dhuruesit e vitit 2019 (data e pa lexueshme), për pacienten D.H, H.SH, - pacienti D.H, dhe pacienti H.SH ka deklaruar se ka lexuar dhe i janë komentuar të gjitha informatat rreth procedurës së dhurimit, të gjitha të drejtat dhe obligimet si dhuruese vullnetare dhe me vetëdije ka pranuar të jetë dhuruese vullnetare për qelizat gjinore duke respektuar të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe se i është bërë kompensimi i shpenzimeve të transportit, analizave të bëra dhe kohës së humbur gjatë procedurës së dhurimit kompensimi në shumë prej 600.00 euro pas përfundimit të procedurës së dhurimit dhe se institucioni shëndetësor nuk ka asnjë obligim ndaj saj.
36. Nga Informatë për dhuruesit e qelizave vezë për FAM, për pacienten D.H, H.SH, pacientet D.H H.SH kanë nënshkruar Informatorin e Qelizave sipas procedurës së Frytnimit të Asistuar Mjekësor (FAM), e cila ka pranuar këtë informator mbi njoftimin e

realizimit të procedurës mjekësore të FAM, ka vendosur dhe është pajtuar me vullnetin e vet dhe pa imponim ti nënshtrohet kësaj procedure. Të njëjtat janë informuar se dhurimi i qelizave vezë bazohet në dhurimin vullnetar dhe të pa paguar duke ruajtur anonimitetin si të dhuruesit ashtu dhe të pranuesit konform ligjit nr.04/L/125 për Shëndetësi, Ligjin nr. 02/L-76 për Shëndetin riprodhues dhe të UA 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor konkretisht nëni 4 pika 3.

37. Nga Dokumenti i lejes së qifteve që i nënshtrohen procedure IVF, ET, ICSI e datës 15.03.2017, para fillimit të procedurës pacientja S.Q më datë 15.13.2017 ka nënshkruar Dokumentin e lejes së qifteve që i nënshtrohen procedurës IVF, ET, ICSI, ka dëgjuar të gjitha sqarimet e mjekut dhe se procedura IVF-ET nuk do të realizohet pa lejen e tyre dhe se është në dijeni për rezultatin dhe komplikimet e mundshme gjatë kësaj procedure dhe se me këtë lejon fillimin e procedurës e IVF-ICSI-ET.
38. Nga Kërkesë nga paditësi drejtuar ISH me nr.05-1784 i datës 12.04.2019.
39. Nga Ekspertizë Financiare nga eksperti A.Z., eksperti në bazë të gjetjeve ka konstatuar se pala paditëse duhet të kompensohet në shumë prej 133,611.17 euro sa i përket fitimit të humbur nga mos zhvillimi i shërbimeve IVF, duke marrë për bazë fitimet e tri viteve paraprake. Të dhënat e shitjeve për shërbimet e IVF janë marrë nga pasqyrat për vitet 2016, 2017, dhe 2018. Shpenzimet materiale direkt për çdo produkt IVF-së janë shtuar plus 300 euro, sipas dokumentacionit nga pala.
40. Nga Plotësim Ekspertizës së ekspertit financiar A.Z. e datës 11.04.2024 Eksperti financiar A.Z. ka konstatuar se dëmi i konstatuar për fitimin e humbur nga mos zhvillimi i shërbimeve IVF duke marrë për bazë fitimin e tre viteve paraprake është 123,714.05 euro, sipas ekspertizës së datës 29.12.2023. Paratë e kthyerat nuk janë trajtuar si dëm, pasi që me ekspertizë janë llogaritur fitimet e humbura. Është konstatuar dëmi material me plotësim ekspertizë prej 40,289.46 euro, për shpenzimet e trajtimit mjekësor, riparimi i pajisjeve dhe shpenzimeve të reklamave. Gjoha e lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor prej 20,000.00 euro dhe interesi prej 8 % prej 14,720.28 euro. Në bazë të gjetjeve eksperti financiar ka konstatuar se pala paditëse duhet të kompensohet në shumë prej 198,723.79 euro (Njëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e njëzet euro e shtatëdhjetë e nëntë cent).

41. Nga Aktvendimi për pushimin e hetimeve PP/I Nr.293/2018 e datës 31.01.2023, Prokuroria Themelore-Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, konstatohet ka pushuar hetimet ndaj të pandehurve V.K., C.Y., A.K., D.K., I.Zh..

Baza Ligjore

42. Ligji Nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues Neni 1, rregullon organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive që zhvillohen në fushën e shëndetit riprodhues, në institucionet shëndetësore, mbron të drejtat riprodhuese të individit e të çiftit duke përfshirë të drejtën për tu informuar dhe për të pasur qasje në shërbime të duhura.

43. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor (FAM), Neni 1 përcakton Qëllimin e këtij Udhëzimi duke cituar se “*Ky udhëzim administrativ rregullon procedurat e frytnimit të asistuar mjekësor, realizimin dhe këshillimin për këto procedura si e drejtë e individit që synon të trajtojë një ose disa shfaqje mjekësore e të infertilitetit, në rast kur çifti nuk arrin shtatëzani të dëshiruar me rrugë natyrore.*”

44. Neni 11 par.1 pika 1.3 përcakton se “*Këshillimi me psikologun klinik i cili obligohet që personat nga par 1.1 ti njoftoj me reaksionet e mundshme psikike për procedurat e FAM dhe të lëshoj raport me shkrim, 1.4, Këshillimi me juristin i cili obligohet nga personat nga nën par. 1.1 ti njoftoj me aspektet juridike për procedurat e FAM dhe të lëshoj raport me shkrim. Neni 15 par. 1.3 përcakton se “*Personi përgjegjës obligohet të informoj dhuruesin për testet e nevojshme laboratorike*”.*

45. Neni 19 par. 1 përcakton se “*Dhurimi i qelizave gjinore bazohet në dhurimin vullnetar dhe pa kompensim, ndërsa par.2 përcakton se “*Marrëveshja për dhurimin e qelizave gjinore e lidhur në kundërshtim me par.1 të këtij neni është e pavlefshme dhe kundërligjore.*”*

46. Neni 20 par. 3 përcakton se “*embrionet e mbetura nëse i plotësojnë kriteret cilësore, ruhet për shfrytëzim eventual vetëm te e njëjta femër sipas kushteve të përcaktuara të këtij udhëzimi administrativ, Neni 24 par. 1 përcakton se “*Qelizat gjinore të dhuruara nga një person, shfrytëzohen deri në lindjen e më së shumti tre fëmijëve të gjallë, par.2, Ndalohet përdorimi i qelizave gjinore të një dhuruesi te çiftet martesore, çiftet*”*

jashtëmartesore dhe te femrat e pa martuara, atëherë kur ato shfrytëzohen për lindjen e më shumë se tre fëmijëve të gjallë.

47. Neni 31 par.1 përcakton se “*Institucionet shëndetësore për marrjen dhe ruajtjen e qelizave gjinore, embrioneve obligohen të vendosin dhe përditësojnë sistemin e kualitetit*”, par. 2 “*Institucioni obligohet ti ndërpres masat e domosdoshme që të siguroj sistemin e kualitetit dhe kontrolli e vazhdueshëm i cili përfshin: procedurën standarde të punës, udhëzime, trajnime, doracak referimi, formularë për raportim, të dhëna për dhuruesin dhe informatë për destinacionin e fundit të qelizave gjinore dhe embrioneve.*
48. Neni 35 par.1 përcakton se “*Institucioni shëndetësor obligohet që të vendos sistemin e identifikimit të dhuruesit që të përcakton kod unik për secilin dhurues dhe për secilin nga produktet që janë të lidhura me dhurimin, me qëllim që të sigurohet vazhdimësia nga dhuruesi te pranuesi dhe anasjelltas*”. Neni 43 par 1, përcakton se “*Institucioni shëndetësor obligohet që të majë regjistër të dhuruesve të qelizave gjinore*”.

Vlerësimi i gjykatës

49. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Çështja kontestuese në këtë konflikt administrativ është anulimi i Vendimit nr. Prot. 05-4250 i datës 08.08.2019 dhe me nr.10/K-014/2019 dhe vendimin Nr.Ref./Aj-019-19 i datës 03.06.2019 i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë.
50. Gjykata i vlerëson të pabazuara pretendimet e përfaqësuesit të paditëses, se vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/K-013/2019 i datës 24.07.2019 si dhe vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr.Ref./Aj-014 i datës 17.05.2019, janë të kundërligjshëm për faktin se Institucioni shëndetësor i cili ka marrë pjesë në inspektimin e paditëses ka vendosur në të dy shkallët brenda organit-ISH, e me këtë rast është shkëlur parimi i dyshkallshmërisë, vërtetuar nga prova materiale, raporti i inspektimit me nr.Prot:05-2436 i datës 17.05.2019 ku qartë vërehet se personi i cili ka përpiluar këtë raport është Znj.N.K., ndërsa nga prova materiale me titullin vendimi nr.10/K-013/2019 i datës

24.07.2019 vërehet se ky vendim i organit të shkallës së dytë është marrë po nga Znj.N.K. e që i bie se i njëjti person ka marrë pjesë në vendosje në të dy shkallët. Gjykata vërteton se vendimi i shkallës së parë Nr.Ref./Aj-014 i datës 17.05.2019, është marrë nga Vendimi i shkallës së parë është i nënshkruar nga Dr. A.Z., Inspektor Shëndetësor, në përputhje me Ligji (Nr. 02/L-38) për Inspektoratin Shëndetësor (LPSH) neni 7.17. ku përcaktohen kompetencat e Inspektorit shëndetësorë në pajtim me Nenin 119, të Ligjit për Shëndetësi ndëshkohen në rastet kur shkelen dispozitat e këtij Ligji, dhe Neni 11.1. Kundër vendimit të Inspektorit shëndetësor, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit mund të i bëhet ankesë Inspektoratit shëndetësor. Neni 3 3.1. përcakton Organizimi i Inspektoratit Shëndetësori, i cili përbëhet nga Kryeinspektori për shëndetësi dhe inspektorët shëndetësorë. paragrafi 3.4. përcakton që Inspektorët shëndetësorë i përgjigjen Kryeinspektorit për shëndetësi.

Prandaj gjykata vlerëson se Vendimi i shkallës së dytë i Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/K-013/2019 i datës 24.07.2019 i marrë nga Dr. N.K. UD Krye Inspektor Shëndetësor, është në përputhje me organizimin e dyshkallshmërisë së ISH dhe në përputhje me kompetencat ligjore.

51. Janë të pabazuara pretendimet se inspektimi është kryer në kundërshtim me ligjin nr.02/L-38 për ISH për faktin se i gjithë inspektimi është kryer nga inspektorët të cilët posedojnë kualifikim më të ulët profesional se sa subjekti i mbikëqyrjes, e kjo bie në kundërshtim me nenin 8 par.2 të ligjit të lartcekur, ndërsa ligji ka paraparë shprehimisht veprimet të cilat duhet të merren nga inspektorati në rastet kur inspektorët anë kualifikim më të ulët profesional se sa objekti i cili i nënshtrohet inspektimit, dhe këto veprime janë të parapara me nenin 1, 2 të ligjit për Inspektoratin Shëndetësor, sepse gjykata rikujton se këto dispozita ligjore i referohen kriterëve që duhet të plotësohen për licencim të inspektorit, por përderisa Inspektori është i licencuar, i njëjti konsiderohet se është i kualifikuar dhe i ushtron kompetencat në pajtim me LPSH, Neni 7. ku përcaktohen Përgjegjësit dhe autorizimet e inspektorëve shëndetësorë, paragrafi 6. ku përcakton Inspektorin aplikimin e masave nga institucionet shëndetësore me qëllim të evitimit të kërcënimit për shëndetin e pacientëve. 7.7. Kërkon të përmirësohen dhe mënjahen pengesat në afat të caktuar të cilat mund të paraqesin shkelje të dispozitave ligjore. Prandaj, Gjykata shqyrtoj padinë në kuptim të nenit 11.3. të LPSH-së, ku përcaktohet: Kundër vendimit përfundimtar të Inspektoratit shëndetësor mund të ngritet kontest administrative në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.

52. Nga Provat e administruara Gjykata konstatoj se gjendja faktike e konstatuar në Vendimin e shkallës së parë nr. AJ-014 i datës 17.05.2019, të Inspektoratit Shëndetësor në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë ku Institucionit Privat Shëndetësor “Klinika Amerikane”, i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore për shërbim të IVF-së, për shkelje të dispozitave të Ligjit për Shëndetësinë 04/L-125 dhe UA Nr. 06/2013, duke e ndëshkuar në pikën II me gjobë në vlerë prej 20,000.00 euro, është bazuar në Një gjendjen faktike të konstatuar në Raport inspektimi me datë 17.05.2019 me nr.2436, nga të gjeturat e procesverbaleve të inspektimeve të realizuara me datë 02.04.2019 nr. 006303, 006304/I, 006305/II, me datë 03.04.2019 006306/III, ku sipas procesverbalit 006303, dosjet e pacientëve të cilët kanë kryer procedura t e IVF-së, janë kontrolluar dosjet 4064/12, 1075, 854 dhe u konstatua që mungojnë informatat si numri i embrioneve, pëlqimi pacientit nënshkrimi i dokumentacionit përkatës. Janë marrë kopjet dhe fotot. Sipas procesverbalit me datë 03.04.2019 006306/III, inspektorët kanë konstatuar se është bërë sanimi i embrioneve të cilat kanë qenë në procedurë nga data 02.04.2019, dhe transferimi i këtyre embrioneve në klinikën Lindja. Më datë 02.04.2019 dhe 03.04.2019 nga raporti i inspektimit janë kontrolluan dosjet e dhuruesve me numër të protokollit 4537, 5737, 8148 ku u konstatua që nuk janë të evidentuara se kujt i janë dhuruar embrionet. Është bërë tërheqja e 25 qelizave në total, të pacientes me nr. të protokollit 5737 në afat kohor 6 muaj më datë 09.11.2018, 07.01.2019, 25.03.2019, nuk ka asnjë shënim se kujt i janë dhuruar këto qeliza, dokumenti i embrioneve deri në destinacion të fundit mungon. Në bazë të nenit 20 par.3 të UA 06/2013 qelizat e dhuruesit duhet të përdoren vetëm te e njëjta femër deri ne lindjen e tre fëmijëve të gjalle, ndërsa në dosjen e pacientit me nr. 960 kanë gjetur që nga një dhuruese janë transferuar qelizat në 2-3 femra, në kundërshtim me nenin 20 par. 3 i UA 06/2013 i cili përcakton se *“embrionet e mbetura nëse i plotësojnë kriteret cilësore, ruhet për shfrytëzim eventual vetëm te e njëjta femër sipas kushteve të përcaktuara të këtij udhëzimi administrativ,* Është bërë kompensimi për dhurim të qelizave në vlerë prej 600-800 euro, që është i evidentuar në dosjen e pacientes me nr. 1075. Është evidentuar që në dosjen e pacientes me nr. 0859/2251 janë të ngrirë 4 embrione, ndërsa në tanke për ruajtjen e embrionit nuk i kishte fare. Mungon sistemi i kodimit për kodin unik të dhuruesit dhe pranuesit me qëllim që të sigurohet vazhdimësia nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas, mungon regjistri i posaçëm për donator (dhurues). Në dosjen e pacientit donatorë me nr. të protokollit 960, 5737, 4537, mungojnë analizat e obliguara për sëmundje ngjitëse,

sëmundjes seksuale transmetuese, mungojnë amneza e plotë, e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut me vulë. Inspektorati është njoftuar nga embriologu që në procedurë të IVF për momentin janë vetëm dy pacient. Në kohën e inspektimit në laboratorin e embriologjisë, ishin në inkubator embrionet e 7 pacientëve me iniciale Rr.SH, XH.K, D.J, A.B, S/V, V.K, B.S, F.SH, më datë 02.03.2019 për shkak të sigurisë tanket me embrione të ngrira janë transferuar, në Spitalin “ Lindja”, për ruajtjen e tyre.

53. Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata konstatoj se paditësi ka dorëzuar: Vlerësimin e psikologut klinik për pacienten Xh.S. se e njëta ka përfunduar këshillimin psikoterapeutik gjatë të cilit psikologu klinik para procedurës, është njoftuar me ndikimet e mundshme psikologjike të Frytnimit të Asistuar Mjekësor, sipas Vërtetimit lidhur me për FAM të datës 21.06.2012, është e njoftuar me të drejtat dhe pasojat ligjore lidhur me lindjen e foshnjës me FAM dhe pëlqimin e procedurës së FAM. ka dorëzuar raportin e analizave lidhur me analizat e kryera në laborator i datës 29.11.2016 me kod unik dhurues KU1075, ku është konstatuar se dhuruesja më datë 29.11.2016 ka filluar procedurën e FAM për pacienten me kod unik 854, është bërë shkrirja e 15 ocistëve, pas shkrirjes janë djeg 2, prej 13 ocistëve, 11 embrione kanë mbetur arrest, janë asgjësuar 2x8c/ab kanë mbetur të gatshme për transferim. Ka dorëzuar vërtetim për pacienten L.M lidhur me njoftimin për FAM i datës 26.02.2018, ku e njëta është njoftuar me të drejtat dhe pasojat ligjore lidhur me lindjen e foshnjës me FAM dhe pëlqimin e procedurës së frytnimit të asistuar mjekësor. Ka dorëzuar Vlerësimin e psikologut klinik për pacienten L.M i datës 26.02.2018, ku është konstatuar ka përfunduar këshillimin psikoterapeutik gjatë të cilit psikologu klinik e ka fituar me ndikimet e mundshme psikologjik të frytnimit të Asistuar mjekësor.
54. Paditësi ka dorëzuar Dokumentin për pacienten S.Q dhe atë: Njoftimi i lejes së qifteve që i nënshtrohen procedure IVF, ET, ICSI, të datës 15.03.2017, ku pacientja para fillimit të procedurës pacientja ka nënshkruar Dokumentin që i nënshtrohen procedurës IVF, ET, ICSI, ka dëgjuar të gjitha sqarimet e mjekut dhe se procedura IVF-ET dhe se është në dijeni për rezultatin dhe komplikimet e mundshme gjatë kësaj procedure dhe se me këtë lejon fillimin e procedurës e IVF-ICSI-ET. Ka dorëzuar Raport i analizave i datës 01.03.2018 për pacienten S.Q, Klinika Amerikane konkretisht Dr. Behar Kusari ku kanë konstatuar se dhuruesja me kod 4064 më datë 26.02.2018 ka filluar procedurën e FAM-it. E njëjta sipas Vlerësimit të psikologut klinik me datë 18.11.2016, para fillimit të

procedurës për frytnimin mjekësor, ka përfunduar këshillimin psikoterapeutik gjatë të cilit psikologu klinik e ka njoftuar për ndikimet (efektet) e mundshme psikologjike të FAM-së. Po ashtu pacientja S.Q është njoftuar me të drejtat dhe pasojat ligjore lidhur me lindjen e foshnjës me FAM dhe pëlqimin e procedurës së frytnimit të asistuar mjekësor. Ka dorëzuar formularin e Informatorit, deklarata mbi dhurimin vullnetarë për Frytnimin e Asistuar Mjekësor

55. Nga Forma e kompensimit ka dorëzuar deklaratën e dhuruesit e vitit 2019 (data e pa lexueshme), për pacienti S.Q, ku ka deklaruar se ka lexuar dhe i janë komentuar të gjitha informatat rreth procedurës së dhurimit, të gjitha të drejtat dhe obligimet si dhurues vullnetar dhe me vetëdije ka pranuar të jetë dhurues vullnetar për qelizat gjinore duke respektuar të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe se i është bërë kompensimi i shpenzimeve të transportit, analizave të bëra dhe kohës së humbur gjatë procedurës së dhurimit kompensimi në shumë prej 400.00 euro pas përfundimit të procedurës së dhurimit dhe se institucioni shëndetësor. Po ashtu për të njejtën paciente ka dorëzuar Informatorin për dhuruesit e qelizave vezë për FAM, pacientja S.Q më datë 15.03.2017 është njoftuar me informatorin mbi njoftimin e realizimit të procedurës mjekësore të FAM, dhe është pajtuar me vullnetin e vet dhe pa imponim ti nënshtrohet kësaj procedure, e njëjta është informuar se dhurimi i qelizave vezë bazohet në dhurimin vullnetar dhe të pa paguar duke ruajtur anonimitetin si të dhuruesit ashtu dhe të pranuesit konform ligjit nr.04/L/125 për Shëndetësi, Ligjin nr. 02/L-76 për Shëndetin riprodhues dhe të UA 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor konkretisht neni 4 pika 3.

56. Paditësi ka dorëzuar Informatorin deklarata mbi dhurimin vullnetarë për FAM për pacienten D.H, H.SH, për Frytnimin e Asistuar Mjekësor FAM, Formën e kompensimit dhe deklarata e dhuruesit për pacienten e vitit 2019 (data e pa lexueshme), ku pacienti D.H, dhe pacienti H.SH ka deklaruar se ka lexuar dhe i janë komentuar të gjitha informatat rreth procedurës së dhurimit, të gjitha të drejtat dhe obligimet si dhuruese vullnetare dhe me vetëdije ka pranuar të jetë dhuruese vullnetare për qelizat gjinore duke respektuar të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe se i është bërë kompensimi i shpenzimeve të transportit, analizave të bëra dhe kohës së humbur gjatë procedurës së dhurimit kompensimi në shumë prej 600.00 euro.

57. Gjykata vlerëson se nga dosjet e dorëzuara nga paditësi nuk është kundërshtuar gjendja faktike e konstatuar në Raportin e inspektimi me datë 17.05.2019 me nr.2436, nga të gjeturat e procesverbaleve të inspektimeve të realizuara me datë 02.04.2019 nr. 006303, 006304/I, 006305/II, me datë 03.04.2019 006306/III, sepse paditësi për ta kontestuar këte gjendjen faktike e cila është konstatuar nga inspektimi i dosjeve specifike, është dashur që konstatimet e të paditurës ti kundërshtoj me po ato dosje, respektivisht në procedurë gjyqësore të vërtetohet me prova se dosjet e inspektuara kanë qenë të kompletuara në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në UA 06/2013. Nga provat e bashkangjitura padisë paditësi nuk ka dorëzua asnjë dëshmi për dosjet inspektuara të pacientëve të cilët kanë kryer procedura të IVF-së, që janë inspektuar nga Inspektorati 4064/12, 1075, 854 dhe u konstatua që mungojnë informatat si numri i embrioneve, pëlqimi pacientit nënshkrimi i dokumentacionit përkatës, dosjet e dhuruesve me numër të protokollit 4537, 5737, 8148 ku është konstatua që nuk janë të evidentuara se kujt i janë dhuruar embrionet, Dosjen e pacientes me nr. të protokollit 5737 ku është konstatuar se është bërë tërheqja e 25 qelizave në total, në afat kohor 6 muaj më datë 09.11.2018, 07.01.2019, 25.03.2019, nuk ka asnjë shënim se kujt i janë dhuruar këto qeliza, dokumenti i embrioneve deri në destinacion të fundit mungon. Nuk është dorëzuar dosja e pacientit me nr. 960 ku është konstatuar se nga një dhuruese janë transferuar qelizat në 2-3 femra. Nuk është dorëzuar dosjen e pacientes me nr. 1075 ku është konstatuar se bërë kompensimi për dhurim të qelizave në vlerë prej 600-800 euro. Nuk është dorëzuar dosja e pacientes me nr. 0859/2251 ku është konstatuar se janë të ngrirë 4 embrione, ndërsa në tanke për ruajtjen e embrionit nuk i kishte fare. Nuk janë dorëzuar dosjet e pacientit donatorë me nr. të protokollit 960, 5737, 4537, ku është konstatuar se mungojnë analizat e obliguara për sëmundje ngjitëse, sëmundjes seksuale transmetuese, mungojnë amneza e plotë, e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut me vulë, dhe nuk është kundërshtuar konstatimi i Inspektorati se me rastin e inspektimit është njoftuar nga embriologu që në procedurë të IVF për momentin janë vetëm dy pacient. Në kohën e inspektimit në laboratorin e embriologjisë, ishin në inkubator embrionet e 7 pacientëve me iniciale Rr.SH, XH.K, D.J, A.B, S/V, V.K, B.S, F.SH, më datë 02.03.2019 për shkaqe të sigurisë tanket me embrione të ngrira janë transferuar, në Spitalin “ Lindja”, për ruajtjen e tyre. Prandaj nga provat e administruara gjykata konstatohet se paditësi ka dorëzuar dosje të pacientëve të tjerë të cilat nuk kanë qenë pjesë e inspektimit. Prandaj nga provat e administruara nuk u vërtetua një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar në Vendimin e datës Nr.10/K-

013/2019 i datës 24/07/2019 dhe Vendimin Nr.Ref/Aj-014 i datës 17.05.2019 të Inspektoratit Shëndetësor.

58. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.245/22, datë 31.05.2024.

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.